



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 05 janar 2021
Nr. ref.:RK 1688/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI166/20

Parashtrues

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ARJ-UZVP. nr. 34/2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës të 6 majit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar në Gjykatën Kushtetuese nga avokatja shtetërore Naime Abazi, e cila punon në Avokaturën Shtetërore të Kosovës në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP. nr. 34/2020 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) të 6 majit 2020, të cilin e ka pranuar më 27 korrik 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] - të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 21 paragrafin 4 dhe nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 tetor 2020, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 2 nëntor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 17 nëntor 2020, Gjykata njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesit dhe parashtruesin e kërkesës se duhet të dorëzojnë në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.
8. Më 20 nëntor 2020, Ministria e Drejtësisë, me anë shkresës nr. MPMS/2020 parashtroi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim të nënshkruar nga Avokati i Përgjithshëm Shtetëror Sami Istrefi.
9. Më 24 nëntor 2020, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e rastit dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
10. Më 24 nëntor 2020, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të dorëzojë fletëkthesën në mënyrë që Gjykata të përcaktojë datën e pranimi të aktgjykimit të kontestuar.
11. Më 26 nëntor 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën për dorëzimin e aktgjykimit [ARJ-UZVP. nr. 34/2020] të Gjykatës Supreme, me datën e dorëzimit 29 korrik 2020.

12. Më 17 dhjetor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 29 korrik 2016, parashtruesi i kërkesës (e paditura, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti për Pensione) me vendimin e MPMS/DP refuzoi kërkesën e paditësit I. M. me numrin e dosjes 193194 për njohjen e të drejtës për pension bazë në shumën mujore prej 75 euro, pension kontribut-pagues në shumën mujore prej 65 euro duke filluar nga 6 qershori 2016. Shuma përgjithshme e pensionit është 140 euro.
14. Në një datë të pacaktuar, paditësi I.M., i pakënaqur me vendimin e mësipërm, parashtroi ankesë te parashtruesi i kërkesës.
15. Më 11 tetor 2016, parashtruesi i kërkesës përmes përgjigjes ndaj ankesës nr. 373 e refuzoi ankesën e paditësit.
16. Më 20 prill 2017, paditësi I.M. parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), duke kërkuar anulimin e vendimit të MPMS/DP të 29.07.2016 dhe përgjigjes ndaj ankesës nr. 373 të lëshuar nga Divizioni për Skemat e Pensionit, me propozim që t'i njihet e drejta për pension kontribut - pagues nga dita e arritjes së moshës për pensionim dhe që t'i kompensohet diferenca ndërmjet pensionit të pleqërisë dhe pensionit kontribut-pagues prej 12.04. 2010 deri më 06.06.2016.
17. Më 29 maj 2018, Gjykata Themelore, me Aktvendimin A. nr. 728/2017, urdhëroi si në vijim:

I. DETYROHET e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që në afat prej 30 ditësh, nga dorëzimi i padisë me të gjitha shkresat të cilat i janë bashkangjitur këtij aktvendimi, t'i paraqesin gjykatës përgjigje në padi në formë të shkruar në dy ekzemplare, nen kërcënimin e pasojave procedurale, si dhe t'ia dërgoj gjykatës, të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me këtë lëndë kontestuese.

II. E paditura është e detyruar që në përgjigje në padi, t'i paraqes prapsimet procedurale dhe të deklarohej se, e pranon apo e konteston padinë e paditësit. Në qoftë se e paditura e konteston padinë e paditësit, përgjegjia ne padi duhet t'i përmbaj faktet, mbi të cilat e paditura i bazon thënjet e saj dhe provat, me të cilat provohen faktet e paraqitura. Përgjigjeja ne padi duhet t'i përmbaj, të gjitha elementet e parapara me dispozitën e nenit 37 te LKA-së, lidhur me nenin 99 të LPK-së.

III. Në qoftë se përgjegjja në padi është e pakuptueshme apo jo e plotë, me qëllim të eliminimit të këtyre të metave, gjykata do të veproj në pajtim me dispozitën e nenit 37.3 te LKA-së, lidhur me nenin 102 të LPK-së.

IV. Personi i cili paraqitet si përfaqësues ligjor është i detyruar që, me rastin e ndërmarrjes së veprimit të parë procedural, të provon cilësinë e

përfaqësuesit ligjor, ndërsa i autorizuari me ndërmarrjen e veprimit të parë procedural, është i detyruar që gjykatës, t'ia paraqes autorizimin e rregullt.

18. Më 26 nëntor 2018, Gjykata Themelore, me Aktvendimin A. nr. 728/2017, pezulloi procedurën sipas padisë së paditësit I.M., me shenjën A. nr. 728/2018 të 20.04.2017, për shkak të vdekjes së paditësit, duke arsyetuar që: *"...kjo qështje ndërpritet deri sa në këtë Gjykatë të mos paraqiten trashëgimtarët e paditësit përkatësisht deri sa mos ndërmarrin veprime me të cilat do të kërkonin ndërmarrjen e ndonjë veprimi në këtë qështje"*.
19. Më 30 nëntor 2018, Avokatura Shtetërore e Kosovës parashtroi përgjigje në padi në të cilën *"...e paditura, Ministria e Punës dhe Mirëqenies, në Prishtinë i PROPOZON Gjykatës që pas administrimit të provave të marr AKTGJYKIM me të cilën REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadija e paditësit duke lënë në fuqi vendimet e të paditurës"*.
20. Më 3 prill 2019, Gjykata Themelore vazhdoi me procedurën e ndërprerë, me kërkesë të përfaqësuesit të paditësit, duke e njoftuar gjykatën se paditësi I.M. është akoma gjallë, duke ia bashkangjitur Gjykatës Themelore vërtetimin e noterizuar LRP. 2556/2019, të lëshuar nga Noteri Gazmend Heta, për të dëshmuar se paditësi I.M., është gjallë. E paditura (parashtruesi i kërkesës) u ftua në mënyrë të rregullt në seancën e shqyrtimit kryesor, e pranoi ftesën më 6 maj 2019 për t'u paraqitur në seancë më 17 qershor 2019 në orën 09:30, por nuk u paraqit në gjykatë dhe nuk e arsyetoi mungesën, seanca u mbajt në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme në pajtim me nenin 41 të LKA-së, në prani të paditësit të autorizuar dhe në mungesë të të paditurës (parashtruesit të kërkesës).
21. Më 17 qershor 2019, Gjykata Themelore me Aktgjykimin A. nr. 728/2017 aprovoi *"...si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, I.M. nga fshati Greme, Komuna e Ferizajt, dhe ndryshoi vendimin e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale Departamenti i Pensioneve në Prishtinë i dt. 29.07.2017 dhe përgjigja në ankesë nr. 373 e dt. 11.10.2016 ashtu që detyrohet e paditura që paditësit t'ia njohë të drejtën në pension kontributpagues që nga arritja e moshës së pensionimit dhe t'ia kompensoj diferencën në mes pensionit të pleqërisë dhe kontributpagues duke filluar nga data 12.04.2010 e deri me dt.06.06.2016 me kamatë ligjore prej 8 % të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi"*.
22. Më 10 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) kundër Aktgjykimit A. nr. 728/17 të 17 shtatorit 2019 të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e parashtruesit të kërkesës dhe të ANULOHET Aktgjykimi A. nr. 728/17 i 17 qershorit 2019 i Gjykatës Themelore.
23. Më 27 janar 2020, Gjykata e Apelit me Aktvendimin AA. nr. 585/2019, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin A. nr. 728/2017 të 17 qershorit 2019 të Gjykatës Themelore.
24. Në Aktvendim Gjykata e Apelit theksoi: *"...Kolegji i gjykatës së apelit duke u nisur nga gjendja e tillë e qështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore*

konkludimet juridike të gjykatës së shkallës së parë sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje genësore të dispozitave të Ligjit për konflikte administrative të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i ekzaminon sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur gjate vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të kontestuar si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, Aktgjykimit të Dhomës së posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 31.03.2016, si dhe provave tjera të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është e bazuar, duke e ndryshuar vendimin e të paditurës, të datës 29.07.2017 dhe përgjigja në ankesë nr. 373 e dt. 11.10.2016; ashtu që c paditura është e obliguar që paditësit t'ia njohë të drejtën në pension kontribut pagues që nga arritja e moshës së pensionimit dhe t'ia kompensoj diferencën në mes pensionit të pleqërisë dhe kontribut pagues duke filluar nga data 12.04.2010 e deri më 06.06.2016 me kamatë ligjore prej 8% të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi“.

“Në raport me pretendimet e të paditurës në ankesë se gjykata ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kur paditësi pas vdekjes ia aprovoi kërkesëpadinë në çështjen administrative të cilin përfaqësonte i autorizuari sipas autorizimit të dhënë nga paditësi sa ishte gjallë. Ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata e shkallës së parë ka vazhduar me procedurën e ndërprerë me kërkesën e përfaqësuesit të paditësit të datës 03.04.2019 me të cilën kërkesë ka njoftuar gjykatën se paditësi është gjallë. E paditura për seancë të shqyrtimit kryesor është ftuar në mënyrë të rregullt ftesën e ka pranuar me datë 06.05.2019, për tu paraqit në seancë të datës 17.06.2019, në ora 09:30, por nuk është paraqitur në gjykatë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, seanca është mbajtur, në mënyrë të rregullt dhe ligjore, si në vështrim të nenit 41 të LKA në praninë të autorizuarit të paditësit e në mungesë të paditurës. I autorizuari i paditësit me datë 21.06.2019, me një parashtrësë gjykatës ia ka bashkangjitur vërtetimin e noterizuar LRP. 2556/2019 të datës 18.06.2019, të lëshuar nga noter Gazmend Heta, për të dëshmuar se paditësi është gjallë.

25. *Më 6 mars 2020, parashtruesi i kërkesës (e paditura) parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AA. nr. 585/2019, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që kërkesa të aprovohet dhe aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta të ndryshohen dhe vendimi i të paditurës të 29.07.2017 të mbetet në fuqi.*
26. *Më 6 maj 2020, me Aktgjykimin ARJ-UZVP - 34/2020, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit (të paditurës, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve), për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AA. UZH. nr. 585/2019, duke arsyetuar që:
 “...Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes qëndrimin juridik e gjykatës shkallës së dytë; në tërësi e pranon si të drejt dhe të ligjshëm; me rastin e refuzimit të ankesës së paditëses, për arsye se*

aktgjykimi i kontestuar nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave të ngritura në kërkesë.

Gjykata vëren se vendimi dhe njoftimi i të paditurës i kontestuar me padi janë të bazuara në Udhëzimin Administrativ nr. 15/2009 i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së këtyre dy akteve nga e paditura, për faktin se i njëjti udhëzim është shfuqizuar me Ligjin nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht me nenin 27.1.1.7 dhe në këtë kuptim gjykata i konsideron këto dy akte ne kundërshtim me ligjin. Po ashtu nga provat e administruara e në bazë të vendimit e të paditurës të datës 29.07.2016, gjykata vëren se paditësit i është njohur e drejta në pension bazë dhe e drejta në pension kontributpagues të moshës nga data 06.06.2016 me arsyetim se janë përmbushur kushtet dhe kriteret e përgjithshme në kuptim të nenit 3 të Ligjit për fondet pensionale të Kosovës nr. 04/L-101 dhe UA nr. 15/2019 për rritjen e pensionit bazë, për pensionet me 15 vjet stazh të sigurimit pensional. Tutje, kjo Gjykate gjen se me aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 31.03.2016 vërtetohet fakti se paditësi ka punuar në Ndërmarrjen 'Plantacioni NSH' nga data 07.08.1979 dha ka 25 vite përvojë pune. Gjykata konsideron se e paditura nuk e ka vlerësuar drejtë gjendjen faktike dhe gabimisht ka vërtetuar gjendjen materiale".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat e rregullta, me vendimet e kontestuarra kanë shkelur nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.
28. Parashtruesi i kërkesës arsyeton shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës "...se të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës duhet të jenë të barabartë para Ligjit, e që në rastin konkret konsiderojmë se Gjykata Themelore në Prishtinë -Departamenti për çështje Administrative, Gjykata e Apelit të Kosovës si dhe Gjykata Supreme e Kosovës kanë shkelur nenin 24 "Barazia para Ligjit" kur z. I.M. ia kanë aprovuar kërkesëpadinë në cilësinë e paditësit (edhe pas vdekjes) duke diskriminuar në këtë rast të gjithë qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës të cilëve, bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 15/2009 u është refuzuar kërkesa e njëjtë e cila paditësit i është aprovuar nga Gjykata më saktësisht u është refuzuar kërkesa për njohjen e të drejtës në pensionin kontribut pagues nga dita e njohjes së të drejtës në pensionin e pleqërisë - e jo nga data e plotësimit të kushtit gjegjësisht nga data e kur aplikuesi vërteton se posedon 15 vite stazh kontribut pagues".
29. Parashtruesi i kërkesës më tej konsideron që "... Aktgjykimet e Gjykatave kanë vënë në pozitë të pabarabartë të gjithë aplikuesit të cilëve u është refuzuar kërkesa në raport me I. M. të cilit i është aprovuar kërkesëpadia dhe i është njohur e drejta në pensionin kontribut pagues –diferenca nga data e plotësimit të kushtit për njohjen e pensionit të pleqërisë nga data 12.04.2010 d deri me dt. 06.06.2016 kur paditësi I. M. ka parashtruar kërkesën për njohjen e të drejtës në pensionin kontribut pagues dhe me prova ka vërtetuar se posedon 15 vite stazh kontribut pagues, në kundërshtim me nenin 2 par. 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2009 i cili e njeh stazhin kontributiv nga data, muaji i

parashtrimin të kërkesës së kompletuar. E që në rastin konkret data, muaji i parashtrimin të kërkesës së kompletuar ka qenë dt. 06.06.2016 e jo data 12.04.2010“.

30. Parashtruesi i kërkesës vetëm përmend shkelje të neneve 31 dhe 102 të Kushtetutës, por as nuk i arsyeton ato dhe as nuk shpjegon se si kishte ardhur deri te shkelja e këtyre neneve, por pretendon se e drejta e parashtruesit të kërkesës është *“...shkelur nga: Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e Kosovës, sepse vendimet e tyre janë në kundërshtim me disa dispozita të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës“.*
31. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën për të konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 24 të Kushtetutës dhe të vendosë si në vijim;

“APROVOHET kërkesa e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë si e BAZUAR.

PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës - ARJ-UZVP. nr. 34/2020 e dt.06.05.2020, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit - A.A. nr. 585/2019 të dt.27.01.2020 si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A. nr. 728/17 të datës 17.06.2019.

REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit Ilaz Mani nga fshati Greme - Komuna Ferizaj, në tërësi si e PABAZUAR“.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj“.

34. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme“.

35. Në vijim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë siç përcaktohet në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa

individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

36. Para së gjithash, Gjykata vëren se në pajtim me paragrafin 4 të nenit 21 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë. (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtrues: Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010).
37. Sa i përket përmbushjes së kriterëve tjera, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar kërkesën në cilësi të palës së autorizuar, duke kontestuar aktin një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin ARJ-UZVP. nr. 34/2020 të 6 majit 2020, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, si dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
38. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*
39. Gjykata fillimisht vëren se rregulli i i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme

për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

40. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „qartazi e pabazuar“ në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*”. (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri me 284).
41. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
42. Sa i përket rastit konkret, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve për shkelje të (i) të drejtave të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, dhe (ii) të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.
43. Sa i përket shkeljeve të mësipërme të të drejtave të garantuara me nenet 24, 31 dhe 102 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) e pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht;
 - a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (Shih: në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);

- b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera zë brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe.

(i) Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës

44. Në lidhje me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila thotë se *“diskriminimi do të thotë trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata relativisht të ngjashme”* (shih: *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 48 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 11 shtatorit 2002; *Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë*, paragrafi 63, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 13 marsit 2006).
45. Më tej, Gjykata rikujton që në mënyrë që pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me diskriminimin të jenë të suksesshme, ata, *inter alia*, duhet të dëshmojnë se pozita e tyre mund të konsiderohet e ngjashme me pozitën e personave tjerë të cilët kanë pasur trajtim më të mirë (shih: *Fredin kundër Suedisë* (nr. 1), paragrafi 60, GJEDNJ, Aktgjykimi i 18 shkurtit 1991).
46. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës arsyeton shkeljen *“...konsiderojmë se Gjykata Themelore në Prishtinë -Departamenti për çështje Administrative, Gjykata e Apelit të Kosovës si dhe Gjykata Supreme e Kosovës kanë shkelur nenin 24 “Barazia para Ligjit” kur z. I.M. ia kanë aprovuar kërkesëpadinë në cilësinë e paditësit (edhe pas vdekjes) duke diskriminuar në këtë rast të grithe qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës të cilëve, bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 15/2009 u është refuzuar kërkesa e njëjtë e cila paditësit i është aprovuar nga Gjykata më saktësisht u është refuzuar kërkesa për njohjen e të drejtës në pensionin kontribut pagues nga dita e njohjes së të drejtës në pensionin e pleqërisë - e jo nga data e plotësimit të kushtit gjegjësisht nga data e kur aplikuesi vërteton se posedon 15 vite stazh kontribut pagues”*.
47. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk paraqet dokumentacion për *“...të gjithë qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës të cilëve, bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 15/2009 u është refuzuar kërkesa e njëjtë e cila paditësit i është aprovuar nga Gjykata më saktësisht u është refuzuar kërkesa për njohjen e të drejtës në pensionin kontribut pagues nga dita e njohjes së të drejtës në pensionin e pleqërisë - e jo nga data e plotësimit të kushtit gjegjësisht nga data e kur aplikuesi vërteton se posedon 15 vite stazh kontribut pagues”*.
48. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk deklaron se cilat të drejta i janë shkelur atij, por përpiqet në mënyrë abstrakte të mbrojë të drejtat për *“...të gjithë qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës,”* pa shpjeguar se si është diskriminuar parashtruesi dhe se si *“...trajtimi i ndryshëm, pa arsyetim objektiv dhe racional,..”* ndaj parashtruesit të kërkesës *“...në raport me personat tjerë në situata relativisht të ngjashme”*.

49. Parashtruesi i kërkesës nuk arsyetoi ose ofroi prova që pozita e parashtruesit të kërkesës mund të konsiderohej e ngjashme me pozitën e një personi tjetër që kishte pasur trajtim më të mirë (shih: *Fredin kundër Suedisë* (nr. 1), paragrafi 60, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 18 shkurtit 1991).
50. Prandaj, Gjykata konstaton se në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, Gjykata arrin në përfundimin se kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohej e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime hyjnë në kategorinë e iii) pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*” sepse parashtruesi i kërkesës thjesht kishte cituar një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se si ato i ishin shkelur parashtruesit të kërkesës, dhe as nuk ka paraqitur prova materiale për të vërtetuar pretendimet e tij për diskriminim. Prandaj, ato janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) sa i përket pretendimit për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës

51. Në rastin konkret, parashtruesi vetëm pretendon shkelje të neneve 31 dhe 102 të Kushtetutës, por nuk arsyeton ose shpjegon se si kishte ardhur deri te shkelja e këtyre neneve, por vetëm pretendon se e drejta e parashtruesit është “...shkelur nga: Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e Kosovës, sepse vendimet e tyre janë në kundërshtim me disa dispozita të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.
52. Prandaj, Gjykata konstaton se përkitazi me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 dhe nenin 102 të Kushtetutës, Gjykata konkludon që kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohej e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i takojnë kategorisë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*” sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se si ato ishin shkelur. Prandaj, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

53. Prandaj, Gjykata konstaton se sa i përket këtyre pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 24, 31 dhe 102 të Kushtetutës, Gjykata konkludon se kërkesa në tërësinë e saj duhet të deklarohej e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse këto pretendime të parashtruesit të kërkesës kualifikohen si pretendime që i takojnë kategorisë (iii) së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”. Prandaj, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 17 dhjetor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Laban Radomir

Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi

